



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) 17 shkronja s) dhe 40.2 shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 14, 15.3, 19 shkronja s) dhe 34.2 shkronja a) të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-1/298-10, dhe në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit nr.01/146-11 të datës 29 prill 2010, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2018, mori,

VENDIM

PËR THEMELIMI I KOMISIONIT STATUTAR PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës së Podujevës, themelohet Komisioni statutar, në këtë përbërje:

1. **Hasan Ajeti**, kryesues nga përbërja e Kuvendit të Komunës
2. **Mrika Thaqi**, anëtare nga përbërja e Kuvendit të Komunës
3. **Bajram Ajeti**, anëtar nga përbërja e Kuvendit të Komunës
4. **Lirika Maliqi**, anëtare nga përbërja e Kuvendit të Komunës
5. **Arbër Blaku**, anëtar nga përbërja e Kuvendit të Komunës
6. **Endritë Murati**, anëtare nga përbërja e Kuvendit të Komunës
7. **Faik Muçiqi**, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës
8. **Gëzim Namani**, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës
9. **Donika Sfishta**, anëtare nga Ekzekutivi i Komunës

Zyra Ligjore e Komunës është pjesë përbërëse e Komisionit sa i përket ofrimit të mbështetje dhe ndihmës profesionale në procesin e hartimit të draftit të aktit.

Neni 2

- Punët dhe detyrat e Komisionit janë:
- Harmonizimi i Statutit si dokument, me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Shqyrtimi i iniciativave - propozimeve të Kryetarit të Komunës, për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit.
- Cakton dhe mban diskutime publike me qytetarë dhe grupe tjera të interesit.
- Shqyrton dhe vendos lidhur me kërkesat, propozimet dhe sugjerimet e paraqitura në diskutime publike.
- Përgatit Raportin final nga diskutimet publike.
- Pas shqyrtimit të draftit përfundimtarë të aktit, Komisioni në fjalë, të njëjtin i'a rekomandon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Neni 3

Komisioni themelohet në mandat të njëjtë me atë të Kuvendit të Komunës, përveç nëse Kuvendi vendos ndryshe.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr. 01-020/04-0014922/18

**Podujevë,
28 shkurt 2018**

